



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"
DREJTORIA E PËRGJITHSHME

NJOFTIM PËR PUNËSIM

Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Q.S.U "Nënë Tereza" kërkon të punësojë **1 (një) Specialist (Koordinator Operator)** në Polin e Administrimit të Integruar të Spitalit Infektiv, të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët janë:

- Arsim i Lartë. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
- Preferohet përvojë pune e mëparshme.
- Të përmbushë në kohë dhe me korrektësi detyrat e ngarkuara;
- Njohuri të mira të sistemit shëndetësor në përgjithësi dhe spitalit në veçanti;
- Njohuri të mira të paketës Microsoft Office;
- Njohuri shumë të mira të procedurave administrative;
- Aftësi të mira komunikimi dhe prezantimi

Për sa më sipër, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat në gjuhën shqipe si më poshtë:

1. Kërkesa me shkrim e shoqëruar me fotokopje e dokumentit të identifikimit (ID)
2. Curriculum vitae (CV), në gjuhën shqipe
3. Fotokopje të diplomës së arsimin të lartë
4. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë)
5. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore
<https://www.qsut.gov.al/wp-content/uploads/2021/09/formular-vetedeklarimi-per-gjendjen-gjyqesore.pdf>
6. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në CV dhe që lidhen me pozicionin për të cilin aplikon.

Depozitimi i aplikimeve do të bëhet pranë zyrës së Marrëdhënieve me Publikun në Drejtorinë e QSU "Nënë Tereza" duke nisur nga data **18.09.2025 ora 08:00** deri më **02.10.2025 ora 16:30**.

Komunikimi për datën dhe orën e Intervistave do të bëhet **nëpërmjet e-mail-it** në CV e kandidatëve.

Të gjithë kandidatët fitues do të rivlerësohen në fund të kontratës 3 (tre) mujore.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME